

AKT - THEMELIMI
I
SHOQËRISË “GREAT WHITE HOTEL” SH.P.K.

Në Lezhë, sot në datën 01.05.2023, une Matilda Kola, Ortak i Vetem si themelues të kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, vendosa të hartoj këtë **Akt Themelimi**, mbështetur në parimet e mëposhtme:

Neni 1

Themeluesit krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të cilën do ta quajmë Shoqëria **“GREAT WHITE HOTEL” sh.p.k.**

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Neni 2

Selia e shoqërisë është në Tiranë në adresën: Rana e Hedhun, Shengjin, Lezhë.

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve mund të ndryshohet selia e shoqërisë, të hapë filiale të saj ose forma të tjera shoqërish, ashtu sikundër do ta shohë të nevojshme shoqëria brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar të veprimtarisë së saj, por sidoqoftë mbi 10 vjet, duke filluar që nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, me përjashtim të rasteve kur shoqëria mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Ortakëve.

Neni 4

Shoqëria **“GREAT WHITE HOTEL” sh.p.k.** do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj : **Hoteleri-turizem:hotel,bar, restorant, piceri, kinema, disco etj.Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj.Ndertim rrugë te kategorive te ndryshme veshje me asfaltobetone te rrugëve /ndertim mbishtrese/ sistemim e asfaltim sheshi.Ndertim vepra arti rrugore e hekurudhore ,ndertime ujesjellesa dhe kanalizime, sillosa, kulla,kulla uji, gurorë,shfrytezim minerale. Te shese e te jape me qera pasuri te tundshme dhe te patundshme.Tregti import-export.Agjenci turistike.**

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kapitali ndahet në 1(nje) Kuote me vlerë nominale 100.000 (njëqindemijë) lekë.

Zoterues në kapitalin e shoqërisë është Z. Matilda Kola.

Neni 6

Shoqëria administrohet nga një administrator i zgjedhur nga Asambleja e Ortakëve. Administrator i parë i shoqërisë është **z. Matilda Kola** per nje afat 5 (pese) vjet.

Neni 7

Ndërtimi, organizimi dhe funksionimi i shoqërisë rregullohet sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar, të statutit, dhe të aktit të themelimit të cilët do të nënshkruhet nga ortakët.

Neni 8

Shoqëria "**GREAT WHITE HOTEL**" sh.p.k. fillon veprimtarinë e saj me nënshkrimin dhe miratimin e dokumenteve të saj të themelimit.

Ky Akt Themelimi është hartuar në katër kopje origjinale, në gjuhën shqipe dhe secila kopje ka fuqi të njëjtë ligjore.

THEMELUES

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Matilda KOLA

Matilda Kola

